



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

PËR

MONITORIMIN E SPEKTRIT TË FREKUENCAVE

Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të AKEP, nr. 26, datë 14.11.2025

KAPITULLI I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i monitorimit

1. Qëllimi i Rregullores është përcaktimi i procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave, të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave me qëllim që:

- a) përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit;
- b) spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
- c) të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore si dhe kompetencave të AKEP;
- d) të mbështesë procesin e administrimit të spektrit duke paraqitur tablo të qartë mbi shfrytëzimin e spektrit nga subjektet e licencuar/autorizuar nga AKEP;
- e) të ofrojë informacionin e duhur në kuadër të procesit të koordinimit të frekuencave me vendet fqinje si dhe zgjidhjes së interferencave të mundshme.

Neni 2

Objekti

Objekti i rregullores është përcaktimi i procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave në zbatim të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Baza Ligjore

Kjo Rregullore hartohet në zbatim të gërmës “dh” të pikës 1, të nenit 12 dhe nenit 64 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

KAPITULI II

MONITORIMI I SPEKTRIT TE FREKUENCAVE

Neni 4

Organizimi i Veprimtarisë së Monitorimit në AKEP

1. Monitorimi kryesisht kryhet në dy forma:
 - a) *Monitorim në distancë*: Kontrolli i gjithë sistemit të monitorimit kryhet nga Qendra e Kontrollit të Monitorimit (MCC), me vendndodhje në godinën e AKEP. Nga MCC, është e mundur të kontrollohen në distancë të gjitha Stacionet Fikse të Monitorimit të instaluar në qytetet e tjera të vendit.
 - b) *Monitorim në terren*: Monitorimi në terren kryhet në mënyrë periodike, nëpërmjet Qendrës së Lëvizshme të Monitorimit dhe pajisjeve të tjera teknike.
2. Monitorimi në terren kryhet pa praninë e përfaqësuesit të sipërmarrësit/subjektit të autorizuar. Pavarësisht kësaj, për shkaqe të ndryshme, ose kur detyra e monitorimit nuk mund të përmbushet ndryshe, specialistët e përfshirë në monitorim kanë të drejtën të kërkojnë praninë e një përfaqësuesi dhe/ose që monitorimi të kryhet në ambientet ku sipërmarrësi/ subjekti ka të instaluar pajisjet transmetuese. Në këtë rast, sipërmarrësi/ subjekti ka detyrimin që të vërë në dispozicion të specialistëve të përfshirë në monitorim një përfaqësues, si dhe të lejojë kryerjen e monitorimit në ambientet ku ka të instaluar pajisjet transmetuese.
3. Çdo pengesë për kryerjen e detyrës së monitorimit përbën kundërvajtje administrative dhe do të ndëshkohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe do të njoftohen organet e Policisë së Rendit për bashkëveprim/mbështetje sipas ligjit, ose do të bashkëpunohet me autoritetet publike vendore në përputhje me termat e marrëveshjes së bashkëpunimit me këto institucione.

Neni 5

Llojet e stacioneve të monitorimit

1. Llojet e stacioneve të monitorimit:
 - a) *Stacion Fiks Monitorimi*: Stacionet Fiks të Monitorimit janë elementi qendror i sistemit të monitorimit të cilët mundësojnë kryerjen e matjeve teknike të zonës ku ata janë instaluar.
 - b) *Stacion i Lëvizshëm Monitorimi*: Stacionet e lëvizshëm të monitorimit kanë funksionin e kryerjes së të gjitha operacioneve monitoruese në zonat të cilat nuk monitorohen nga stacionet fikse.

Neni 6

Monitorimi nga Stacionet Fikse

1. Qendra Kombëtare e Monitorimit të Frekuencave (QKMF) ka të instaluar një program kompjuterik i cili bën të mundur menaxhimin/kontrollin në distancë të Stacioneve Fikse të Monitorimit (RFMS).
2. Monitorimet programohen automatikisht në sistem dhe ekzekutohen sipas planit mujor për secilin nga Stacionet Fikse të Monitorimit. Brenda çdo muaji monitorohen të gjitha stacionet fikse dhe përgatitet raport monitorimi mbi matjet e kryera.

Neni 7

Monitorimi nga Stacioni i Lëvizshëm

1. Për kryerjen e monitorimit të lëvizshëm përdoret Qendra e Lëvizshme e Monitorimit të Frekuencave (QLMF) si dhe çdo pajisje tjetër e disponueshme e transportueshme.
2. Monitorimi në terren do të kryhet bazuar në planin vjetor të monitorimit, në ankesat për interferencë të paraqitura në AKEP si dhe kërkesat nga të interesuarit.
3. Përdorimi i pajisjeve të monitorimit bëhet në përputhje me instruksionet që përshkruajnë rrjedhën e punës dhe procedurat standarde të matjeve, duke u bazuar në Manualin e Monitorimit (Monitoring Handbook – ITU) dhe manualin e pajisjeve.

Neni 8

Procedura e monitorimit

1. Monitorimi kryhet kryesisht dhe/ose me kërkesë të sipërmarrësit/subjektit që zotëron një autorizim të lëshuar nga AKEP.
 - a) Monitorimi kryesisht:
 - i. Monitorimi në distancë kryhet çdo ditë, sipas planit mujor dhe aktet e monitorimit i dërgohen Drejtorit të Drejtorisë përgjegjëse për monitorimin e frekuencave; Nëse konstatohen transmetime të jashtëligjshme përgatitet raport informues për Kryetarin;
 - ii. Monitorimi në terren kryhet në bazë të Autorizimit të Monitorimit të lëshuar nga Kryetari i AKEP sipas aneksit 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, në funksion të qëllimit të monitorimit.
 - iii. Për kryerjen e monitorimit në terren përdoret Qendra e Lëvizshme e monitorimit të frekuencave, si dhe çdo pajisje tjetër e disponueshme nga AKEP.
 - iv. Monitorimi në terren mund të kryhet në çdo kohë, pavarësisht nga kohëzgjatja normale e punës së specialistëve përkatës dhe/ose e përdoruesit të frekuencës që monitorohet.

- v. Çdo pengesë për kryerjen e detyrës së monitorimit, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - b) Monitorimi me kërkesë të sipërmarrësit/subjektit:
 - i. Monitorimi i spektrit të frekuencave mund të bëhet edhe me kërkesë të sipërmarrësve/subjekteve të cilët zotërojnë një autorizim të lëshuar nga AKEP, në rastin e shmangies së interferencave.
 - ii. Kërkesa e sipërmarrësit/subjektit të interesuar, duhet të jetë me shkrim dhe e argumentuar.
2. AKEP-i bashkëpunon për monitorimin e frekuencave, nëse një kërkesë e tillë vjen nga institucionet e tjera, të ngarkuara për administrimin e spektrit të frekuencave.

Neni 9

Detyrat kryesore të monitorimit

1. Detyrat kryesore të monitorimit, në përputhje me qëllimin e kësaj rregulloreje, me funksionet dhe detyrat kryesore të AKEP, të përcaktuara në ligjin nr.54/2024, janë:
 - a) Matja e përgjithshme e përdorimit të kanalit dhe brezave, përfshirë edhe verifikime të disponueshmërisë së frekuencave (shfrytëzimi i spektrit).
 - b) Verifikimi i zbatimit të kushteve të licencës nga sipërmarrësit/subjektet që zotërojnë një autorizim të lëshuar nga AKEP,
 - c) Matja e parametrave dhe karakteristikave teknike të sinjaleve bazuar në standardet dhe rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare (analizë sinjali).
 - d) Dedektimi i interferencave elektromagnetike të spektrit.
 - e) Dedektimi dhe identifikimi i transmetimeve të paautorizuara.
 - f) Monitorimi në raste të veçanta si ngjarjet e mëdha sportive dhe vizitat shtetërore;
 - g) Monitorimi në kuadër të studimeve teknike dhe shkencore.

Në zbatim të këtyre detyrave, AKEP, kryesisht kryen aktivitete monitorimi, për të identifikuar në kohë interferencat dhe transmetimet e paautorizuara.

2. Aktivitetet verifikuese përfshijnë ndër të tjera matjet si më poshtë:
 - a) Okupimi i Brezit të Frekuencave (FBO)
 - b) Okupimi i Kanalit të Frekuencave (FCO)
 - c) Matje të modulimit/devijimit
 - d) Matje të intensitetit të fushës (përfshirë matjet e fuqisë dhe densitetin e fluksit të fuqisë PFD)
 - e) Matje të gjerësisë së brezit
 - f) Matje të mbulimit

- g) Matje të frekuencës
- h) Analizë e sinjalit dhe identifikim të transmetuesit
- i) Matje mikrovalore
- j) Analiza rreth përdorimit të emetimeve të përjashtuara nga regjimi i autorizimit (Pajisjet e Distanca të Shkurta (SRD))
- k) Diagrama e antenës
- l) Lartësia e antenës/azimuti
- m) Koordinatat gjeografike
- n) Tipi i modulimit

KAPITULLI III

PROGRAMIMI I VEPRIMTARISË SË MONITORIMIT DHE RAPORTIMI

Neni 10

Plani i Monitorimit

1. Monitorimi kryhet mbi bazën e planeve vjetore të hartuara për zbatimin e detyrave të monitorimit që burojnë nga Radio Rregulloret e ITU (ITU-R) dhe në përputhje me manualin e ITU (Monitoring Handbook – ITU), rekomandimet/vendimet CEPT.
2. Plani Vjetor i Monitorimit përcakton në detaje veprimtarinë e monitorimit që do të ndërmerret gjatë vitit ushtrimor nga AKEP, i cili përfshin ndër të tjera:
 - a) Kontrollin periodik të pikave kryesore të transmetimit në Republikën e Shqipërisë për verifikimin e zbatimit të kushteve të përdorimit të frekuencave nga operatorët e autorizuar;
 - b) Verifikimin e përdorimeve të paligjshme të spektrit për identifikimin e përdoruesve të paautorizuar, identifikimin dhe burimin e interferencave.
 - c) Matje të okupimit të kanaleve specifike (FCO) për të mbështetur procesin e Autorizimit të sipërmarrësve për dhënie të së drejtës së përdorimit të frekuencave;
 - d) Matjeve të okupimit të brezave specifike (FBO) në mbështetje të administrimit të frekuencave;
 - e) Tipet e matjeve që do të kryhen, brezat e frekuencave që do të monitorohen dhe sa shpesh;
 - f) Stacione fikse të ngarkuar me projekte të paracaktuar, sipas zonave gjeografike që mbulojnë.
3. Plani vjetor i monitorimit propozohet nga Drejtoria përgjegjëse për monitorimin e frekuencave dhe miratohet nga titullari i AKEP.
4. Plani vjetor i monitorimit publikohet në faqen www.akep.al menjëherë pas miratimit.
5. Plani mujor i monitorimit, i cili del në zbatim të Planit vjetor, propozohet nga Sektori përkthës i caktuar për monitorimin e frekuencave dhe miratohet nga Drejtori përgjegjës.

Neni 11

Autorizimi i Procesit të Monitorimit

1. Monitorimi kryhet mbi bazën e një Autorizim monitorimi të nxjerrë nga Kryetari, rast pas rasti, sipas planit të monitorimit dhe përmban:
 - a) pikat e transmetimit që do të monitorohen
 - b) listën emërore të specialisteve të Monitorimit
 - c) llojin e matjeve që do të kryhen
 - d) datën e fillimit të monitorimit dhe afatin e përfundimit të tij
 - e) përshkrimin e qëllimit dhe detyrës
 - f) pajisjet dhe antenat që do të përdoren për matjet
2. Grupi i monitorimit, në çdo rast përbëhet nga jo më pak se 2(dy) specialistë të monitorimit të frekuencave, me të drejta dhe përgjegjësi të barabarta ligjore për realizimin e detyrës sipas Autorizimit të monitorimit dhe kësaj rregulloreje.
3. Dalja në terren dhe kryerja e matjeve bëhet vetëm pasi grupi i monitorimit të jetë pajisur me Autorizimin e monitorimit. Asnjë person nuk mund të dalë për kryerjen e matjeve pa qenë i pajisur me Autorizimin e kryerjes së monitorimit.

Neni 12

Raporti i monitorimit

1. Në përfundim të çdo procesi matjesh dhe monitorimi, personeli i përfshirë në matje përgatit raportin e monitorimit, me përmbajtje si më poshtë:
 - a) përshkrim i qëllimit dhe detyrës;
 - b) personeli i përfshirë në detyrë;
 - c) data dhe koha gjatë së cilës është kryer detyra;
 - d) pajisjet dhe antenat që janë përdorur për matjet dhe monitorim;
 - e) vlerat e matura të frekuencës, gjerësia e brezit, mbulimi, Okupimi Brezit të Frekuencave (FBO), Okupimi i Kanalit të Frekuencave (FCO), densiteti i fluksit të fuqisë, intensiteti i fushës, shenja e thirrjes, analizë e sinjalit etj. dhe shkeljet, në qoftë se ka të tilla;
 - f) printime me pamje nga analizatori i spektrit dhe marrësi;
 - g) kushtet mjedisore të cilat mund të ndikojnë në saktësinë e matjeve;
 - h) konkluzionet dhe rekomandime për veprime të mëtejshme, kur është e nevojshme.
2. Raporti firmoset nga të gjithë anëtarët e grupit të monitorimit.
3. Rezultatet e matjeve të monitorimit fiks, regjistrohen, analizohen dhe përmbledhen në një Raport Periodik 6-mujor.
4. Me qëllim ruajtjen e të dhënave dhe përpunimin efektiv të tyre, të gjitha të dhënat e monitorimit ruhen në një bazë të veçantë të dhënash.

Neni 13

Baza e të dhënave

1. Sektori i Monitorimit krijon dhe mban të përditësuar bazën e të dhënave me informacion nga aktiviteti i monitorimeve të kryera.
2. Baza e të dhënave përmban, si më poshtë:
 - a) përshkrim i qëllimit dhe monitorimit;
 - b) specialistët e përfshirë në monitorim;
 - c) data dhe koha gjatë së cilës është kryer monitorimi;
 - d) pajisjet që janë përdorur për monitorimin;
 - e) vendi ku është kryer monitorimi;
 - f) subjektet e monitoruar;
 - g) rezultatet e monitorimit;
 - h) masat e marra.
3. Sektori i monitorimit bashkëpunon me sektorin e administrimit të frekuencave për verifikimin e kushteve të autorizimit të përdoruesve të pajisur me Autorizim Individual si dhe identifikimin e përdoruesve të paautorizuar.

Neni 14

Të drejtat dhe detyrimet e monitoruesve

1. Specialistët e përfshirë në monitorim duhet të jenë të pajisur me dokument të posaçëm identifikues nga AKEP, i cili përmban emrin/mbiemrin, fotografinë e tij dhe pozicionin e punës si dhe me autorizimin e monitorimit të firmosur dhe vulosur nga Kryetari.
2. Specialistët e përfshirë në monitorim kanë të drejtë të fotografojnë pajisjet e transmetimit apo ambientet e sipërmarrësve/subjekteve për të dokumentuar procedurën, apo rezultatet e monitorimit.
3. Specialistët e përfshirë në monitorim gjatë kryerjes së procesit të monitorimit duhet të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe ato të përdorimit të pajisjeve.
4. Ndalohej dalja në terren dhe kryerja e monitorimit në kushte të rënda atmosferike veçanërisht në rastet e shkarkimeve atmosferike.

Neni 15

Te drejtat dhe detyrimet e sipërmarrësve/subjekteve

1. Sipërmarrësit/subjektet që zotëron një autorizim të lëshuar nga AKEP janë të detyruar të lejojnë personat përgjegjës të monitorimit, që të kryejnë monitorimin në ambientet e tyre të transmetimit.

2. Sipërmarrësit/subjektet janë të detyruar t'i japin specialistëve të përfshirë në monitorim çdo informacion, të dhënë dhe/ose dokumentacion tjetër të nevojshëm në lidhje me procesin e monitorimit.

Neni 16

Kundërvajtjet administrative

1. Çdo përdorim i spektrit të frekuencave në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore të dala në dhe për zbatim të tij, përfshi edhe këtë rregullore.

Neni 17

Procedura e vlerësimit të matjeve

1. Kur gjatë ushtrimit të detyrave monitoruese, specialistët e AKEP konstatojnë se përdorimi i frekuencave nuk është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe/ose në zbatim të kushteve të autorizimit individual, përgatisin relacionin e konstatimit, i cili sipas rastit i njoftohet ose nënshkruhet nga subjekti i monitoruar.
2. Relacioni duhet të përmbajë informacion të hollësishëm për subjektin, datën, orën, frekuencën e monitoruar dhe shkeljen konkrete.
3. Relacioni, së bashku me çdo dokumentacion tjetër shoqërues, i kalon, sipas kompetencës, kryetarit të AKEP.
4. Pas vlerësimit të relacionit të konstatimit, si dhe materialit përkatës, kryetari të AKEP, sipas kompetencës, autorizon strukturat përgjegjëse të AKEP për të ndjekur procedurën e inspektimit.
5. Subjekti njoftohet zyrtarisht dhe i jepet e drejta e shpjegimit lidhur me shkeljen e kryer.
6. AKEP, në zbatim të ligjit dhe provave të paraqitura vendos masën administrative përkatëse (paralajmërim, urdhër për ndërprerje funksionimi, gjobë etj.).
7. Vendimi i AKEP i komunikohet subjektit që ka kryer shkeljen.
8. Parashikimet e këtij neni nuk e pengojnë AKEP që të kryejë një inspektim pranë përdoruesit të frekuencës, sipas Rregullores së inspektimit.

KAPITULLI IV

RREGULLA TEKNIKE TË PROCESIT TË MONITORIMIT

Neni 18

Sigurimi teknik gjatë matjeve në terren

1. Përgjegjësi i grupit të matjeve, është përgjegjës për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.
2. Ndalohej nxjerrja në operim dhe kryerja e matjeve në kushte të rënda atmosferike, veçanërisht në rastet e shkarkimeve atmosferike.
3. Në çdo rast, gjatë realizimit të matjeve stacionare duhet bërë tokëzimi i QLMF në përputhje me rregullat e tokëzimit.
4. Staf i përdorues i QLMF nuk duhet të qëndrojë pranë pjesëve të cilat mund të bëhen objekt goditje me pasojë dëmtimin e shëndetit (p.sh, nuk lejohet të qëndrohet përballë shtyllës teleskopike gjatë ngritjes dhe uljes së saj).
5. Nuk lejohet kryerja e matjeve nëse QLMF nuk është vendosur në kushte optimale për realizimin e matjeve (nuk lejohet qëndrimi në vende të pjerrëta të papërshtatshme për realizimin e matjeve).
6. Montimi i antenave të nevojshme për kryerjen e matjeve bëhet në përputhje me udhëzimet e përdorimit për secilën pajisje.
7. Kyçja/ shkyçja e burimit të ushqimit (energji elektrike) për qendrën e monitorimit bëhet në përputhje me instruksionet e përcaktuara në manualin e përdorimit.
8. Lëvizja e automjetit bëhet vetëm pasi të jetë siguruar që çdo pajisje është në vendin e duhur dhe se lëvizja e automjetit nuk përbën rrezik për dëmtimin e pajisjeve.

Neni 19

Instruksionet

1. Përdorimi i pajisjeve të monitorimit bëhet në përputhje me instruksionet që përshkruajnë rrjedhën e punës dhe procedurat standarde të matjeve.
2. Instruksionet gjenden të përcaktuara në Manualin e Monitorimit (Monitoring Handbook – ITU) dhe manualin e pajisjeve që përdoren për të kryer monitorimin.

Neni 20

Sigurimi i Qendrës së Lëvizshme të Monitorimit të Frekuencave

1. Qendra e Lëvizshme e Monitorimit të Frekuencave, në të cilën janë instaluar pajisjet e monitorimit, gjatë kohës që nuk është në përdorim, do të qëndrojë e mbyllur në ambientet e AKEP.
2. Në rast se gjatë kryerjes së matjeve do të jetë i nevojshëm moskthimi në ambientet e AKEP, QLMF do të sigurohet në komisariatit të policisë së qytetit të qëndrimit ose në ndonjë repart ushtarak të afërt.

KAPITULLI V ADMINISTRIMI I INTERFERENCAVE

Neni 21 Procedura administrative

1. Çdo ankesë për interferencë duhet të depozitohet në AKEP duke përdorur formën e “Raportimit të Interferencës” (Aneksi 3) në Modulin e Aplikimeve Online të përcaktuar i cili është në dispozicion në faqen web www.aplikimeonline.al.
2. Në rastet kur ka interferencë të dëmshme në frekuencat e sistemeve të sigurisë publike dhe shërbimeve në raste fatkeqësish, ankesa për ndërhyrje mund të dërgohet edhe në adresën zyrtare të AKEP info@akep.al ose në formë shkresore. Në këto raste AKEP do të trajtojë në mënyrë të menjëhershme ankesën.

Neni 22 Veprimtaria e AKEP në zgjidhjen e interferencës

1. Bazuar në Planin Kombëtar të Frekuencave, përdoruesit të cilët përdorin pajisje radio në frekuenca të përcaktuara për shërbime dytësore (pa autorizim individual), përjashtohen nga e drejta e ankimit për interferencë, duke qenë se këto janë breza të pambrojtur.
2. Kur një ankesë për interferencë është njoftuar, AKEP do të analizojë informacionin e siguruar dhe përshtatshmërinë për të ndërmarrë veprime. Drejtoria përkatëse do të kategorizojë ankesën në vijim dhe veprimet që do të iniciohen në përputhje me rrethanat:
 - a) interferencë në sigurinë publike
 - b) interferencë në Republikën e Shqipërisë
 - c) interferencë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë
 - d) interferencë nga Republika e Shqipërisë jashtë territorit
 - e) interferencë në hapësirën ajrore (shërbimet e radionavigimit aeronautik dhe ato satelitore)
 - f) të tjera
3. Për të përcaktuar burimin e interferencës dhe për të bërë eliminimin, AKEP do të marrë masat e mëposhtme:
 - a) kryerjen e monitorimit të frekuencave radio për të bërë identifikimin dhe përcaktimin e vendndodhjes së burimit të interferencës;
 - b) kryerjen e monitorimit në terren në vendet e dyshuara si shkaktare/burim të interferencës, përfshirë edhe vendndodhjen e subjektit ankimues kur dyshohet ai mund të jetë burimi i interferencës
4. Në rastet kur ankesa është bërë nga Organe Administrative jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ku sipas shpjegimeve dyshohet se burimi i interferencës është një përdorues i autorizuar vendas, AKEP mund të kërkojë ndërprerjen e përkohshme të transmetimit, duke koordinuar veprimtarinë edhe me administratën ankuese për të kryer matjet e nevojshme.

5. Përgjigja përfundimtare ndaj ankesave të ardhura nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të zyrtarizohet vetëm pas analizës së AKEP.
6. Në çdo rast që AKEP konstaton interferencë të dëmshme për shkak të shkeljes së njërit prej termave të mëposhtme:
 - a) shkelja e termave dhe kushteve të autorizimit të lëshuar nga AKEP për një përdorues të autorizuar
 - b) përdorimi i paautorizuar i brezit të frekuencave
 - c) instalimi i paautorizuar i pajisjeve radio
 - d) importi i paautorizuar i pajisjeve transmetuese pa tel (wireless)
 - e) shkelja e rregullave ose politikave të AKEP.

procedon në zbatim të ligjit nr. 54/2024 dhe akteve rregullatore në fuqi, ndaj sipërmarrësit/subjektit (person fizik ose juridik) i cili shkakton interference. Raporti i monitorimit i dërgohet subjektit ankues, jo më vonë se 15 ditë nga dita e njoftimit të ankesës për interferencë.

7. Me vendosjen e komunikimit zyrtar AKEP i bën me dije sipërmarrësit/subjektit se duhet të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e interferencës. Sipërmarrësit/subjektit i jepet mundësia e dhënies së shpjegimeve me shkrim brenda 5 (pesë) ditë pune, në lidhje me interferencën për të bërë të ditur nëse ndërhyrja është e justifikuar. Bazuar në përgjigjen e përdoruesit ndërhyrës, AKEP, përcakton nëse shkelja e përdoruesit ishte e qëllimshme apo ka ndodhur për shkak të arsyeve që janë jashtë kontrollit të përdoruesit.
8. Në rast të shkeljeve të qëllimshme dhe të përsëritura nga një sipërmarrës, AKEP, do të iniciojë masat administrative sipas dispozitave të ligjit nr. 54/2024.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

Neni 23

Shfuqizimi

1. Rregullorja nr. 44, datë 13.10.2016 për “Monitorimin e spektrit të frekuencave” shfuqizohet.
2. Rregullorja nr. 35, datë 23.12.2014 për “Administrimin e Interferencave” shfuqizohet.

Neni 24

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues në përputhje me ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Kjo Rregullore publikohet në faqen zyrtare në internet të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

ANEKSI 1: AUTORIZIM MONITORIMI



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . ____

AUTORIZIM MONITORIMI

Në zbatim të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar:

Autorizohet Grupi i Punës me përbërje:

Emër Mbiemër, (pozicioni)

1. _____
2. _____
3. _____ ; _____

(a. qëllimi i monitorimit/ b.pikat e transmetimit që do të monitorohen/ c.pajisjet e përdorura për monitorim)

Nisja për në (vendi) do të bëhet më datë ____ . ____ . ____ , dhe kthimi do të jetë në (vendi) më datë ____ . ____ . ____ .

Lëvizja do të kryhet me makinat e AKEP:

Makina _____, me targë _____.

ANEKSI 2: RELACION KONSTATIMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE TË FUNDME**

RELACION KONSTATIMI

Bazuar në Autorizimin nr. _____, datë _____._____._____, të Kryetarit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), nr._____, datë_____._____._____, Grupi i Punës gjatë kryerjes së monitorimit në mjediset _____ ku janë vendosur pajisjet e subjektit _____, dhe në prezencë të përfaqësuesit të subjektit _____, konstatoi shkeljet si më poshtë:

1. _____
2. _____
3. _____

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin _____, të Vendimit nr. _____, datë _____._____._____, “Për miratimin e rregullores për monitorimin e spektrit të frekuencave”, të Këshillit Drejtues të AKEP, Grupi i Punës, informon Kryetarin e AKEP, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së inspektimit.

GRUPI I PUNËS

PËR SUBJEKTIN

ANEKSI 3: RAPORTIMI I INTERFERENCAVE

RAPORTIM PËR INTERFERENCË



Reference Aplikimi **A K E P - x x x x - x x - x x x x x**
Datë Aplikimi **VVVV-MM-DD**

Pjesa 1 - Te Dhënat e Sipërmarrësit	
Emri i Personit (juridik/fizik)	
Adresa Vendbanimi/Zyra qendrore e Personit (juridik/fizik)	
Qyteti / Shteti	
Telefon	
Email	
Website	
Personi (juridik/fizik) është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) në:	
Datë Regjistrimi në QKR:	
Rregjistruar si (SH.A.; SH.P.K., etj.):	
NIPT:	
Emri i Përfaqësuesit ligjor të Personit (juridik/fizik):	
Numri personal i letërnjoftimit/kartës së identitetit-ID:	
Telefon:	
E-mail	
Person kontakti (Drejtuuesi Teknik):	
Telefon:	
E-mail	
Përshkrimi i natyrës së interferencës	
Konstatimi i parë i Interferencës	
Kanali	

Lloji i Interferencës	
Nëse është me ndërprerje - Specifikoni kohën kur ajo shfaqet	
Nëse është me ndërprerje - Në çfarë intervalesh kohore përsëritet: prej _____ deri _____	
Nëse është me ndërprerje - Në çfarë intervalesh kohore përsëritet: prej _____ deri _____	
Sa është koha që vazhdon të jetë prezente në stacionin radio?	
Mbulueshmëria - Qyteti apo rajoni	
Mbulueshmëria - Koordinatat	
Intensiteti i sinjalit interferues të marrë	
Kuptueshmëria e sinjalit interferues të marrë	
Gjuha e përdorur sipas ITU-së	
Burimi i Interferencës	
Jepni informacionet e mundshme për subjektin që shkakton këtë ndërhyrje	
Gjerësia e kanalit dhe lloji i transmetimit	
Vendodhja e Tx e kanalit Interferues	
Përdorni ju Ton Kontrolli në pajisjet	
Nëse po, cili është toni?	
Janë kontrolluar pajisjet tuaja, pas shfaqjes së interferencës, nga furnizuesi i pajisjeve?	
Nëse po jepni të dhënat e plota, e të sakta për vendndodhjen e secilit prej tyre	
Informacione shtesë	